KËRKESË
Nr. 1204/11, datë 30.12.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 617, datë 29.7.2020, 'Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rruga e Arbrit' (shtesa)"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 25 500 *(njëzet e pesë mijë e pesëqind) lekë.*

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 384, DATË 29.6.2023, 'PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT"'

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE							VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	VLERA (m²)		
1	Kujtim	Osman	Sinani	3444	5/83	Arë	1313	255	100	25,500	25,500	
TOTALI											25,500	